



Npi – 01/287 Datë: 30.08.2024

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) nenit 17 shkronja (o) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Nenin 24 të Ligjit për Sistemin e Adresave Nr.04/L-071 i datës 08.12.201; Nenin 54.8 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Si dhe duke marrë parasysh propozimin e Kryetarit të Komunës së Shtimes, Nr.02/897 të datës 22.08.2024, dhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa me numër Npi-01/281 të datës 28.08.2024, Kuvendi në mbledhjen e mbajtur më 30.08.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR ZGJEDHJEN E KOMISIONIT PËR EMËRTIMIN E OBJEKTEVE PUBLIKE NË KOMUNËN E SHTIMES

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VIII- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më datën: 30.08.2024, unanimisht, miratoi Vendimin për formimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për emërtimin e objekteve publike në Komunën e Shtimes, në këtë përbërje:

1. Muhamet Ademaj..... përfaqësues nga pozita,
2. Besnik Seferi..... përfaqësues nga pozita,
3. Idajet Rexhepi.....përfaqësues nga ekzekutivi i Komunës,
4. Isak Asllani.....përfaqësues nga ekzekutivi i Komunës,
5. Banush Imeri.....përfaqësues nga komuniteti intelektual,
6. Basri Hyseni.....përfaqësues nga komuniteti intelektual,
7. Ruzhdi Jashari.....përfaqësues nga Shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së.

II

Komisioni i vlerësimit të kërkesave për emërtimin e objekteve publike, është i përkohshëm (deri në zgjedhjet e reja lokale). Komisioni bën shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për emërtimin e objekteve publike në komunën e Shtimes, dhe i rekomandon Kuvendit për miratim.

III

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi Anulohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Shtimes për formimin e komisionit të vlerësimit të kërkesave për emërtimin e objekteve publike në Komunën e Shtimes Npi – 01/314 i datës: 31.10.2019.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi